

ALFREDO ROCCO



**DOKTRINA POLITIKE
E FASHIZMIT**



ALFREDO ROCCO

**DOKTRINA POLITIKE
E FASHIZMIT**

Përktheu: Juxhin Halo

Redaktoi: Faust

© Botimet Brerore

brerore@outlook.com

2021

1. Fashizmi si Veprim, si Ndjenjë dhe si Mendim.

Shumë është thenë e thuhet, pro dhe kundër këtij fenomeni politik dhe shoqëror të ndërlikuar që në periudhën e shkurtër prej gjashtë vjetësh ka pushtuar tërësisht jetën italiane, dhe duke u përhapur përtej kufijve të Mbretërisë, është ndjerë ca më shumë e ca më pak nëpër botë. Por njerëzit kanë qenë më të gatshëm t'a lartësojnë ose t'a qortojnë, dhe jo ta kuptojnë - çka është mjaftueshëm e natyrshme në këtë periudhë të entuziazmit të trazuar, e të pasionit politik.

Nuk ka mbërritur ende koha e një gjykimi gjakftohtë. Madje dhe unë që vura re mishërimet e para të këtij zhvillimi të madh, pashë rëndësinë e tij dhe mora pjesë në veprat e para, duke vëzhguar të gjithë zhvillimet e hershme, të ndryshueshme dhe të pasigurta, nuk ndihem mjaftueshëm i pajisur me aftësi për të dhënë një gjykim të qartë. Fashizmi është një pjesë kaq e madhe e imja, sa përpjekja për t'a shkëputur personalitetin tim nga ai, përpjekja për t'ia nënshtruar një gjykim të paanshëm me qëllim vlerësimin e ftohtë dhe të saktë, do ishte njëherazi arbitrare dhe absurde.

Gjithsesi, edhe pse rrallëherë tentohet, mund të shqyrtojmë brenda fenomenit duke mos marrë parasysh thjesht aspektet fragmentare dhe të jashtme, duke u munduar të futemi brenda në thelb. Kjo sipërmarrje mund të mos jetë e lehtë, por është e nevojshme.

Koha është mëse e përshtatshme, sepse tek ky përorim i ciklit të leksioneve që kryesisht synojnë të ilustrojnë atë prirje të vjetër dhe të lavdishme të jetës dhe historisë së Italisë, që merr emrin e vet nga shenjtori modest i Azisit, duket e natyrshme lidhja me arritjen më

të madhe të Italisë moderne, e ndryshme në kaq shumë aspekte nga lëvizja Françeskane, por njëherazi e bashkuar me të, në sajë të rrymës së përbashkët të Historisë Italiane. Vendi është gjithashtu i përshtatshëm, sepse në Peruxhia, mendja është e orientuar më së miri për nga hetimet e kësaj natyre. Fundja, idetë tona fetare, idetë politike si dhe shkenca jonë ligjore u zhvilluan shumë në Peruxhia, përgjatë shekujve më të lavdishëm të historisë sonë kulturore.

Fillimisht le ta pyesim veten nëse ekziston një doktrinë politike e Fashizmit; nëse ka ndonjë përmbajtje ideale në Shtetin Fashist. Në mënyrë që ta lidhim Fashizmin si koncept dhe sistem me historinë e mendimit Italian, duhet të provojmë se është mendim, pra doktrinë.

Shumë njerëz nuk janë dhe aq të bindur për vërtetësinë e njërës apo tjetrës; e nuk po i referohem vetëm atyre njerëzve të kultuar ose jo, të cilët gjenden kudo, e të cilët dallojnë në këtë risi politike vetëm aspektet lokale dhe personale. Flas për ata që gjejnë tek Fashizmi një mënyrë sjelljeje, të këtij apo atij fashisti, të këtij apo atij grupi në një qytet të caktuar, pra ata që e pëlqejnë ose jo lëvizjen vetëm sipas preferencave për individët që e përfaqësojnë.

Nuk i referohem as atyre njerëzve inteligjentë e të kultuar, përnjëmend shumë inteligjentë dhe të kultuar, që për shkak të besnikërisë së drejtpërdrejtë ose jo ndaj partive që janë menjanuar nga mbërritja e Fashizmit, kanë një arsye natyrore për ta urryer, dhe prej verbimit që shkakton urrejtja, janë të paaftë për të qëmtuar ndonjë gjë të mirë tek ai.

Në fakt, i referohem atyre njerëzve ndërmjet rradhëve tona, që e njohin Fashizmin si veprim dhe ndjenjë, por

ende jo si mendim, ata njerëz pra që përmes intuitës kanë përjetuar fashizmin, por ende nuk e kuptojnë.

Është e vërtetë që Fashizmi mbi të gjitha është ndjenjë dhe veprim, këtë rrugë duhet të vazhdojë të ndjekë. Po të vlente e kundërta, nuk do mbahej dot lart ajo forcë e madhe lëvizëse, ajo fuqi rinovuese. Po të vlente e kundërta, Fashizmi do të ishte thjesht përsiatja vetmitare e disa të zgjedhurve.

Fashizmi mund t'i lëvizë shpirtrat e njerëzve dhe të çlirojë një rrymë të parzistueshme të vullnetit kombëtar sepse është ndjenjë dhe përjetim, vetëm sepse është rizgjimi i pandërgjegjshëm i instiktit tonë më të thellë racor. Duke qenë së është veprim, dhe si i tillë mishërohet në një organizatë të gjerë dhe në një lëvizje të madhe, ai i përmbush kushtet e përcaktimit të rrjedhës historike të Italisë bashkëkohore.

Gjithsesi Fashizmi është mendim, dhe zotëron një teori, e cila është pjesë thelbësore e këtij fenomeni historik. Teoria e Fashizmit në një masë të madhe ka qenë faktor kyç i sukseseve të mëdha. Kësaj ekzistence të përmbajtjes ideale të Fashizmit, dhe kësaj të vërtete të logjikës Fashiste, ne i atribuojmë faktin e besnikërisë ndaj parimeve, edhe pse mund të bëjmë shumë gabime në detaje.

Krejt e kundërta ndodh me partitë opozitare të cilat në mungesë të një parimi informues dhe gjallërues, në mungesë të një koncepti orientues, luftojnë siç ua lejon stërvitja dhe manovrat parlamentariste dhe gazetareske, pra një luftë detajesh. Në të njejtën kohë ata thërrmohen kur u duhet të përballen me çështjet përnjëmend të rëndësishme.

Originaliteti i Fashizmit rrjedh prej autonomisë së parimeve teorike. Sepse edhe kur në shfaqjet e jashtme dhe në përfundimet përkatëse duket sikur është identik me doktrinat e tjera politike, në fakt ai zotëron një origjinalitet të brendshëm, në sajë të shpirtit që e gjallëron, dhe në sajë të një qasjeje teorike krejtësisht të ndryshme.

2. Zanafilla dhe sfondi i përbashkët i doktrineve politike moderne: Nga Liberalizmi tek Socializmi

Mendimi politik modern ka mbetur deri në ditët e sotme, si në Itali por edhe jashtë Italisë, nën kontrollin absolut të atyre doktrineve të cilat meqenëse lindën nga Reforma Protestante dhe u zhvilluan nga idhtarët e ligjit natyror të shekujve 18 dhe 19, u themeluan fort tek institucionet dhe zakonet e Revolucioneve Angleze, Amerikane dhe Franceze.

Nën forma të ndryshme dhe ca herë kontradiktore, këto doktrina kanë lënë një gjurmë vendimtare mbi të gjitha teoritë dhe veprimtaritë njëherazi shoqërore dhe politike të shekujve 19 dhe 20, deri tek mbërritja e Fashizmit. Themeli i përbashkët i të gjitha këtyre doktrineve që shtrihen nga Longuet, Buchanan dhe Althusen deri tek Karl Marx, Ëilson dhe Lenin, është një konceptim shoqëror dhe shtetëror të cilin do ta quaj mekanik ose atomik.

Sipas këtij konceptimi shoqëria është thjesht shuma e individëve që e përbëjnë. Një shumësi që ndahet në përbërës të veçuar e singularë. Pra qëllimi i një shoqërie, nuk është tjetër veçse shuma e qëllimeve të individëve që e përbëjnë, e që në sajë të të cilëve kjo shoqëri ekziston. Një pikëpamje e tillë atomike, është domosdoshmërisht anti-historike, përderisa e shqyrton shoqërinë përmes vetish hapësinore dhe jo kohore. Ajo gjithashtu e redukton jetën shoqërore tek ekzistenca e një brezi të vetëm. Shoqëria konsiderohet si shumë e individëve të determinuar, pra një brez që jeton në një kohë të caktuar. Poshtë mantelit fshehës të kësaj doktrine atomike dhe anti-historike, qëndron një natyrë thellësisht materialiste.

Në përpjekjet e saj për të izoluar të tashmen nga e kaluara dhe e ardhmja, ajo mohon trashëgiminë shpirtërore të ideve dhe ndjenjave që çdo brez merr nga i mëparshmi, duke ia lënë pasardhësve në një moment të dytë. Në këtë mënyrë, kjo doktrinë përpiqet të shkatërrojë unjisinë dhe vetë jetën shpirtërore të shoqërisë njerëzore.

Ky themel i përbashkët tregon lidhjen e afërt logjike që ekziston ndërmjet të gjitha doktrinave politike; solidaritetin substancial që përbashkon të gjitha lëvizjet politike, nga Liberalizmi tek Socializmi, që deri në kohët e sotme kanë dominuar Europën. Të gjitha këto shkolla politike dallojnë nga njëra-tjetra në metode, por të gjitha dakordësohen përse i përket synimeve.

Të gjitha këto doktrina konsiderojnë mirëqenien dhe lumturinë e individëve si qëllim të shoqërisë, e cila përbëhet nga individët e brezit të sotëm. Të gjitha këto doktrina shikojnë tek shoqëria, dhe tek organizimi i saj juridik, pra Shteti, vetëm instrumentet dhe mjetet përmes të cilave individët mund të arrijnë synimet vetjake. Ato dallojnë vetëm tek metodat që ndiqen për arritjen e këtyre synimeve.

Pra liberalët këmbëngulin se mënyra më e mirë për të siguruar mirëqenien e qytetarëve si individë, është ndërhyrja sa më e pakët në zhvillimin e lirë të aktiviteteve të tyre. Pra detyra thelbësore e Shtetit është thjesht të koordinojë liritë me qëllim garantimin e bashkëekzistencës së tyre. Kanti, filozofi më i fuqishëm dhe më besnik i liberalizmit thoshte “Njeriu është qëllimi, nuk mund të supozohet se ai ka vlerën e një mjeti”. Diku më tej “Shteti është organi i drejtësisë, drejtësia është gjendja ku liria e secilit kushtëzohet nga liria e të tjerëve, sipas ligjit të përgjithshëm të lirisë”

Duke përkufizuar kështu detyrën e Shtetit, Liberalizmi kufizohet tek kërkesa e garancive të caktuara të cilat nuk e lejojnë Shtetin të kapërcejë funksionet e tij si koordinator i përgjithshëm i lirive, dhe nga flijimi i lirisë së individëve më tepër se ç'është domosdoshmërisht e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të tij.

Ky sistem i shtrëngimeve dhe kufizimeve, që ndryshe quhet “qeverisje kushtetuese” çoi në një liberalizëm modest dhe të matur. Fuqia kufizuese ushtrohej vetëm nga ato qytetarë që u gjykuan si të vlefshëm dhe të aftë. Përfundimi i këtij procesi ishte formimi i një elite të vogël që përfaqësonte ligjërisht trupin politik, në të mirë të të cilit ky regjim ishte krijuar.

Megjithatë ishte e dukshme që ky sistem modest, themeli dhe parimet e të cilit ishin alogjike dhe kontradiktore, do të bëhej shumë shpejt shënjestër e një kritike serioze. Nëse objekti i shoqërisë dhe i Shtetit është mirëqenia e individëve, si është e mundur të pranojmë se kjo mirëqenie mund të sigurohet nga vetë individët vetëm përmes mundësive të një regjimi liberal?

Pabarazitë e prodhuara nga natyra dhe nga organizimi shoqëror, janë aq të panumërta dhe aq serioze, sa në një masë të madhe individët e kufizuar vetëm tek vetja, jo vetëm që do të dështonin në arritjen e lumturisë, por gjithashtu do të kontribuonin në përjetësimin e një gjendjeje mjerimi dhe hidhërimi. Shteti pra nuk mund ta kufizohet vetëm rreth funksionit negativ të mbrojtjes së lirive. Ai duhet të bëhet aktiv, në emër të të gjithëve, për miërqenien e popullit.

Duhet të ndërhyjë sa herë të jetë e nevojshme në mënyrë që të përmirësojë kushtet materiale, intelektuale dhe morale të masave. Duhet të gjejë punë për të papunët,

të edukojë dhe të udhëzojë popullin, të kujdeset për shëndetin dhe higjenën.

Nëse synimi i shoqërisë dhe Shtetit është mirëqenia e individëve, dhe nëse vetë këto individë janë në gjendje të kontrollojnë udhën e synimeve vetjake, bëhet tepër e vështirë të kuptosh pse Liberalizmi nuk duhet të ndjekë përfundimin e tij logjik, pse duhet të bëjë dallimin mes individëve të caktuar dhe masave, dhe pse funksionet e njerëzve duhen kufizuar vetëm tek shtrëngesa e Shtetit.

Pra Shteti, nëse ekziston për të gjithë, duhet të qeveriset nga të gjithë, dhe jo nga një pakicë e vogël; nëse shteti ekziston për popullin, sovraniteti duhet t'i përkasë popullit; nëse të gjithë individët kanë të drejtën e qeverisjes, liria nuk mjafton më; duhet shtuar barazia; dhe nëse sovraniteti i mvishet njerëzve, njerëzit duhet t'a zotërojnë të gjithin, dhe jo të jenë thjesht pjesë e tij. Fuqia për të shtrënguar dhe kufizuar qeverinë, nuk mjafton më. Populli duhet të jetë qeveria.

Kështu, përfundimi logjik i Liberalizmit është Demokracia. Demokracia përmban premtimet e Liberalizmit, por i shkel kufijtë e tij, i bën veprimet e shtetit pozitive, deklaron barazinë e të gjithë qytetarëve nëpërmjet dogmës së sovranitetit popullor. Demokracia pra domosdoshmërisht implikon një formë republikane të qeverisjes, edhe pse disa herë për arsye përshtatshmërie, përkohësisht toleron një regjim monarkik.

Teksa zbresim poshtë kësaj shkalle të deduksioneve logjike, kalimi në një pozicion më të përparuar i kësaj teorie atomike të Shteti dhe shoqërisë, bëhet i pashmangshëm. Zhvillimet e mëdha industriale si dhe ekzistenca e një mase të madhe punëtorësh, të keqtrajtuar dhe në një gjendje prej gjysmë-skllevërish, një gjendje

mundësisht e durueshme në një regjim të industrisë vendase, kjo gjendje pra u bë e patolerueshme pas revolucionit industria. Prandaj nga gjysma e shekullit të kaluar e më tej, patëm një situatë mizore dhe kërcënuese.

Pyetja e radhës bëhet natyrshëm: “Nëse Shteti është krijuar për mirëqenien e qytetarëve të tij, si mund të tolerojë një sistem ekonomik që e ndan popullatën në një pakicë shfrytëzuesish nga njëra anë, dhe një shumësi të madhe të shfrytëzuarish nga ana tjetër? Jo! Shteti përsëri duhet të ndërhyjë dhe t’i çelë shteg një sistemi ekonomik të ndryshëm e jo të paudhë. Duke shfuqizuar pronën private, duke kontrolluar drejtpërsëdrejti prodhimin, dhe duke e organizuar atë në një mënyrë ku prodhimi i punës të shpërndahet vetëm midis atyre që punojnë, klasës punëtore.

Këtu gjejmë Socializmin, me organizimin e tij ekonomik të shoqërisë, shfuqizimin e pronësisë private të kapitalit dhe mjeteve të prodhimit, socializmin e prodhimit, shtypjen e vlerës së shtuar të kapitalit, dhe shpërndarjen e gjithë prodhimeve tek klasa punëtore. Është e kuptueshme që Socializmi njëherazi e përmban dhe e kapërcen Demokracinë, ashtu si Demokracia njëherazi e përmbante dhe e kapërcente Liberalizmin, gjithnjë duke qenë një zhvillim më i përparuar i të njejtij koncept themeltar.

Socializmi prodhon doktrinën më të skajshme të Bolshevizmit, që kërkon shtypjen e dhunshme të mbajtësve të kapitalit, diktaturën e proletariatit si mjet të një organizimi më të drejtë të shoqërisë, si dhe shpëtimin e klasës punëtore nga shfrytëzimi kapitalist.

Kështu, Liberalizmi, Demokracia dhe Socializmi duket se janë, ashtu siç janë në realitet, jo vetëm pjella e

një teorie të qeverisjes, por edhe derivime logjike të njëra-tjetrës.

Përfundimi logjik i Liberalizmit është Demokracia; përfundimi logjik i Demokracisë është Socializmi. Është e vërtetë që për shumë vite, dhe me disa justifikime, Socializmi konsiderohej si e kundërta e Liberalizmit. Por kjo cilësi antitetike është qartësisht relative, ajo thërrmohet teks i afrohemi themelit dhe zanafillës së përbashkët të dy doktrinave, sepse gjejmë që kundërshtia është kundërshti metode, dhe jo synimi. Synimi është i njëjtë për të dyja – mirëqenia e pjesëtarëve individualë të shoqërisë. Dallimi qëndron në faktin se Liberalizmi udhëhiqet nga liria, kurse Socializmi përpriqet ta arrijë me anë të organizimit kolektiv të prodhimit.

Pra nuk ka asnjë antitezë ose mosmarrëveshje mbi natyrën dhe fushëveprimin e Shtetit, si dhe marrëdhënien e individëve me shoqërinë. Ka vetëm një dallim të vlerësimit mbi mjetet e arritjes së synimeve, dhe themelimit të marrëdhënieve. Ky dallim varej krejtësisht nga kushtet ekonomike të kohërave të caktuara, kohëra në të cilat këto doktrina u formuluan. Liberalizmi mbërriti dhe u zhvillua gjatë periudhës së industrisë së vogël; Socializmi u zhvillua me ngritjen e industrializmit dhe kapitalizmit botëror. Mosmarrëveshja midis këtyre dy pikëpamjeve, ose antiteza, kufizohet vetëm tek fusha ekonomike. Socializmi konkurren me Liberalizmin vetëm për shkak të organizimit të prodhimit dhe shpërndarjes së të mirave materiale.

Përsa i përket çështjeve fetare, morale dhe intelektuale, Socializmi, është liberal, ashtu siç është liberal dhe demokrat në politikë. Anti-liberalizmi dhe Anti-demokratizmi i Bolshevizmit janë në vetvete

kontingjente. Bolshevizmi është revolucionar, prandaj i kundërvihet Liberalizmit, aspekti socialist është i përbashkët. Nëse kundërshtia mes Bolshevizmit dhe Doktrinë liberale dhe demokratike vazhdon, përfundimi mund të jetë një thyerje e plotë mes Bolshevizmit dhe Socializmit, edhe pse synimet e të dyjave janë identike.

3. Fashizmi si Doktrinë Integrale e Veprimtarisë Shoqërore. Fashizmi si Antitezë e Atomizmit të teorive Liberale, Demokratike dhe Socialiste.

Antiteza e vërtetë, jo ndaj këtij apo atij mishërimi të konceptimit liberal-demokratik-socialist të shtetit, por të vetë konceptit, gjendet tek doktrina e Fashizmit. Teksa mosmarrëveshja mes Liberalizmit dhe Demokracisë, dhe mes Liberalizmit dhe Socializmit qëndron në një dallim metodik, siç kemi thënë, hendeku mes Socializmit, Demokracisë dhe Liberalizmit nga njëra anë, dhe Fashizmit nga ana tjetër, qëndron tek një dallim në koncept.

Fashizmi kurrë nuk ka dyshime për metodën, ai herë përdor në praxisin e vet politik metoda liberale, herë metoda demokratike, e madje dhe metoda socialiste. Ky injorim i metodës shpesh është përdorur nga vëzhgues sipërfaqësorë, për ta akuzuar Fashizmin për mospërputhje me teori. Për ne rëndësi ka synimi. Ne kemi të njëjtin synim, prandaj edhe kur veprimet përmes metodave të ndryshme, qëndrimi shpirtëror është radikalisht i ndryshëm, për pasojë edhe përfundimet që duam të arrijmë janë krejtësisht të ndryshme.

Koncepti Fashist i Kombit, i fushëveprimit të Shtetit dhe i marrëdhënieve midis shoqërisë dhe përbërësve individualë, e mohon tërësisht doktrinën që siç thashë më parë, rrjedh nga teoritë e ligjit natyror të zhvilluar gjatë shekujve 16. 17 dhe 18.

Nuk do të përpiqem këtu t'a shpjegoj këtë doktrinë, por do të kufizohem me një përmbledhje të koncepteve themelore.

Njeriu – kafsha politike – sipas përkufizimit të Aristotelit, jeton dhe duhet të jetojë në shoqëri. Një qenie njerëzore jashtë juridiksionit të shoqërisë, është një gjë e pamendueshme, një jo-njeri. Njerëzimi në tërësinë e tij ndahet në grupe shoqërore, që janë të panumërta dhe të larmishme. Ato ndryshojnë për nga rëndësia dhe organizimi, që nga fiset e Afrikës Qendrore dhe deri tek Perandoritë e mëdha Perëndimore. Shoqëritë e ndryshme janë ndarje të species njerëzore, secila prej tyre e pajisur me një organizim të unjisuar. Meqë nuk ka ndonjë organizim unik të species njerëzore, nuk ka “një”, por “disa” shoqëri njerëzore. Njerëzimi pra ekziston vetëm si një koncept biologjik, jo si një i tillë shoqëror.

Çdo shoqëri ekziston në sajë të unjisisë së përmbajtjeve biologjike dhe shoqërore. Vetëm një pjesë e species njerëzore është e pajisur me një unjisi organizimi të përshtatshëm për arritjen e synimeve të veçanta të species.

Ky përkufizim na paraqet të gjithë elementet e fenomenit shoqëror, dhe jo vetëm ato që lidhen me ruajtjen dhe përjetësimin e species. Sepse njeriu nuk është thjesht lëndë; kurse synimet e species njerëzore, larg nga synimet e përbashkëta materialiste që kemi me kafshët, janë kryesisht synime shpirtërore të veçanta vetëm për njeriun. Çdo formë shoqërore përpiqet t'i arrijë këto synime ashtu siç ia lejon faza e zhvillimit shoqëror. Kështu, organizimi i çdo grupi shoqëror, përshkohet nga flukset shpirtërore të: unjisisë gjuhësore, unjisisë kulturore, asaj fetare, asaj tradicionale, asaj zakonore, dhe përgjithësisht, unjisisë së ndjenjës dhe vullnetit. Këto flukse janë po aq thelbësore sa elementet materiale:

unjisia e interesave ekonomikë, e kushteve të jetesës, dhe e territorit të përbashkët.

Përkufizimi i dhënë më sipër na tregon një tjetër të vërtetë që është injoruar nga doktrinat politike të katër shekujve të fundit. Koncepti shoqëror ka një aspekt biologjik, sepse grupet shoqërore janë ndarje të species njerëzore, secila nga to e pajisur me një organizim të veçantë, një zhvillim të veçantë qytetërimor, shkurt, çdo grup shoqëror ka një jetë tije. Nëse grupet shoqërore janë ndarje të species njerëzore, ato duhet të jenë të pajisura me tipare themelore të species njerëzore. Ato duhen konsideruar si një vazhdimësi brezash, dhe jo si një kolektivitet individësh.

Pra është e dukshme se meqë specia njerëzore nuk është shuma e gjithë qenieve njerëzore të botës, po ashtu edhe grupet shoqërore të ndryshme nuk janë shuma e individëve që në një moment të caktuar në kohë i përkasin grupit. Grupet shoqërore janë vargje të pafundme të brezave të shkuar, të sotëm e të ardhshëm që e përbëjnë.

Fashizmi pra e zëvendëson teorinë e vjetër atomike dhe mekanike që është në themel të doktrinave liberale dhe demokratike, me një koncept organik dhe historik. Kur them organik, nuk dua të jap përshtypjen e strukturimit të shoqërisë si një organizëm, sipas mënyrës të së ashtuquajturave “teori organike të Shtetit”; në vend të kësaj, po tregoj që grupet shoqërore si ndarje të species, kanë një jetë dhe një fushëveprim që tejkalon jetën dhe fushëveprimin e individëve që vetëidentifikohen me historinë dhe synimet e vargut të pandërprerë të brezave. Përcaktimi i grupeve shoqërore si organizma, është i parëndësishëm. E rëndësishme për ne është të pohojmë që ky koncept organik i Shtetit i ofron shoqërisë një jetë të

pashkëputur, mbi dhe përtej ekzistencës së disa individëve.

Doktrina Fashiste pra, i përmbys marrëdhëniet mes Shtetit dhe qytetarëve. Në vend të formulës liberal-demokrate “shoqëria për individin” ne kemi formulën “individët për shoqërinë”. Por edhe në formulën tonë ekziston një dallim. Ndërsa doktrinat liberale e zhdukën shoqërinë, fashizmi nuk e zhduk individin. Fashizmi i’a nënshtron individin shoqërisë, por jo duke e zhdukur. Individu edhe pse i përkohshëm dhe jo shumë i rëndësishëm, ekziston si pjesë e brezit të tij, si element i shoqërisë.

Për më tepër, zhvillimi i koordinuar dhe harmonik i individëve të çdo brezi, kushtëzon zhvillimin dhe mirëqenien e të gjithë njësisë shoqërore.

Në këto rrethana, antiteza ndërmjet dy teorive duhet të shfaqet si e plotë dhe absolute. Liberalizmi, Demokracia dhe Socializmi i konsiderojnë grupet shoqërore si shumatore individësh; për Fashizmin ndërkohë, ato janë unjisia përsëritëse e një vargu të pafundëm brezash. Për Liberalizmin, shoqëria nuk ka ndonjë synim tjetër përveç synimeve të individëve që jetojnë në një kohë të caktuar. Për Fashizmin, shoqëria ka synime historike dhe imanente të ruajtjes, zgjerimit, përmirësimit, krejtësisht të dallueshme prej synimeve të individëve që përbëjnë grupin në një kohë të caktuar.

Për Liberalizmin, shoqëria nuk zotëron një jetë sajën të dallueshme nga jeta e individëve. Ose siç thuhet:”solvitur in singularitates”. Për Fashizmin, jeta e shoqërisë i mbivendoset ekzistencës së individëve, duke u projektuar tek brezat në vazhdim, nëpër shekuj dhe mijëvjeçarë. Individët lindin, rriten, dhe vdesin, duke u

ndjekur nga të tjerë pandërprerë; unjisia shoqërore gjithmonë mbetet e njëjlojtë.

Për Liberalizmin, individi është synimi kurse shoqëria është mjeti; është e pamendueshme që individi i parë në dritën e dinjitetit të një synimi përfundimtar, të ulet në rrafshin e instrumentalitetit. Për Fashizmin, shoqëria është synimi, individi është mjeti. Individët janë mjetet të cilët Fashizmi i përdor për të arritur synimet shoqërore.

Shteti pra ruan dhe mbron mirëqenien dhe zhvillimin e individëve, jo për hir të interesit vetjak, por prej përputhjes së nevojave të individit me ato të mbarë shoqërisë. Pra ne mund t'i pranojmë dhe t'i shpjegojmë ato institucione dhe praktika që ashtu si dënimi me vdekje, ndëshkohen nga Liberalizmi në emër të epërsisë së individualizmit.

Problemi themelor i shoqërisë përsa i përket doktrinave të vjetra, është çështja e të drejtave të individëve. Këto të drejta mund të jenë: e drejta e lirisë siç thonë Liberalët, e drejta për qeverisjen e bashkësisë siç thonë Demokratët, ose e drejta për drejtësi ekonomike, siç pretendojnë Socialistët. Në çdo rast flitet vetëm për të drejtat e individëve, ose për të drejtat e grupeve të përbëra nga individë (klasat). Përgjigjia e Fashizmit ndaj problemit të të drejtave është e qartë. Në Fashizëm mund të flitet vetëm për të drejtën e Shtetit dhe detyrat e individëve. Të drejtat e individëve njihen vetëm për aq kohë sa implikohen tek të drejtat e Shtetit. **Vlera më e lartë etike e Fashizmit gjendet tek kjo epërsi e detyrës.**

4. Problemet e Lirisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë Shoqërore në Doktrinën Politike të Fashizmit.

Nuk duam të themi që problemet e ngritura nga shkollat e tjera të mendimit injorohen nga Fashizmi. Thjesht duam të qartësojmë që ne përballemi me këto probleme në mënyra krejtësisht të ndryshme, siç përballemi përshembull me problemin e lirisë.

Ekziston një teori Liberale e lirisë, ashtu siç ekziston një koncept Fashist i lirisë. Ne e konsiderojmë të domosdoshme ruajtjen e kushteve që sigurojnë zhvillimin e lirë të individit; edhe ne besojmë që shtypja e personalitetit individual nuk ka vend në shtetin modern. Veçse për ne është krijimi i një karte të të drejtave që e vë individin sipër shtetit është i papranueshëm, për ne është i papranueshëm fuqizimi i individit deri në atë shkallë sa ai të mund të veprojë kundër shoqërisë. Sipas konceptit tonë të lirisë, individi duhet lejuar të zhvillojë personalitetin e tij në emër të Shtetit, sepse këto janë elementet e përkohshme dhe jashtëzakonisht të vogla që prej zhvillimit të tyre normal, përcaktojnë zhvillimin e Shtetit. Ky zhvillim individual duhet të jetë normal.

Një zhvillim anormal dhe i shpërpjesëtuar i individëve të klasave, do të ishte fatal për shoqërinë, ashtu siç është mishi i huaj për një organizëm të gjallë. Liria pra i përket qytetarit dhe klasave, por me kusht që t'a ushtrojnë në të mirë të shoqërisë, dhe brenda kufijve të vendosura nga nevojat shoqërore. Liria është, si çdo e drejtë tjetër individuale, një lëshim i Shtetit. Kjo që them për liritë qytetare vlen dhe për lirinë ekonomike. Fashizmi nuk e konsideron doktrinën e lirisë ekonomike si një dogmë absolute. Nuk i'a referon problemet ekonomike

nevojave individuale, interesave individuale, dhe zgjidhjeve individuale.

Krejt e kundërta, zhvillimi ekonomik dhe në veçanti prodhimi i bollëkut, konsiderohet si një shqetësim shoqëror, sepse bollëku është një element i fuqisë dhe i mirëqenies shoqërore. Për Fashizmin, kohërat normale lypin një liri ekonomike e cila i shërben më së miri synimeve shoqërore. Detyrat e prodhimit dhe shpërndarjes i besohen individit, me shpresën se do të jenë fitimprurëse. Në sferën ekonomike, ambicia individuale është mjeti më i efektshëm për të arritur qëllimet më të mira shoqërore. Pra, edhe në çështjen e lirisë ekonomike, Fashistët dallojnë katërcipërisht nga Liberalët.

Të dytët shikojnë tek liria një parim, kurse të parët një metodë. Sipas Liberalëve, liria njihet në të mirë të qytetarëve; Fashistët e njohin në të mirë të shoqërisë. Me fjalë të tjera, Fashizmi e bën individin një mjet ekonomik në të mirë të shoqërisë, një mjet i cili mund të përdoret për aq kohë sa funksionon, dhe të nënshtrohet kur nuk është më i dobishëm. Nëpërmjet këtyre rregullave, Fashizmi zgjidh problemin e përjetshëm të lirisë ekonomike dhe ndërhyrjes së Shtetit. Të dyja këto janë thjesht metoda që mund të përdoren ose jo, në përputhje me nevojat shoqërore të momentit.

Çka thashë për Liberalizmin politik dhe ekonomik, vlen edhe për Demokracinë. Demokracia përpiqet të përballet me problemin e sovranitetit. Edhe Fashizmi përpiqet, por në një mënyrë tjetër. Demokracia ia mvesh sovranitetin popullit, masës së njerëzve. Për fashizmin sovraniteti i qenësishëm është vetëm ai lloj sovraniteti që organizohet juridikisht si Shtet. Demokracia i'a dorëzon

qeverisjen e Shtetit masës së njerëzve, në mënyrë që ata t'a përdorin në të mirë të interesave vetjake.

Fashizmi këmbëngul që qeveria t'i besohet njerëzve të aftë për t'i kapërcyer interesat vetjake, njerëz të cilët do të jenë mëse të aftë për të realizuar aspiratat e kolektivitetit shoqëror, i parë në dritën e e unjisisë së tij, dhe marrëdhënies me të kaluarën e të ardhmen. Fashizmi pra jo vetëm mohon dogmën e sovranitetit popullor duke zëvendësuar me sovranitetin e Shtetit, por gjithashtu deklaroi që masa e madhe e qytetarëve nuk është e përshatshme për të mbrojtur interesin shoqëror.

Kapaciteti për të injoruar interesin vetjak në të mirë të interesit shoqëror është një gjë shumë e rrallë, është privilegj i të paktëve. Inteligjenca natyrore dhe përgatitja kulturore i shërbejnë më së miri detyrave të këtilla. Ndoshta edhe më e vlefshme është intuita e mendjeve të mëdha të rralla, tradicionalizmi i tyre, dhe cilësitë e trashëguara. Çka thashë më sipër gjithsesi, nuk duhet keqkuptuar si një përjashtim i plotë i masave nga ndikimi i tyre në jetën e Shtetit.

Krejt e kundërta, ndërmjet popujve me histori dhe tradita fisnike, edhe elementët më të ulët të shoqërisë, zotërojnë një aftësi instiktive për të dalluar domosdoshmëritë në të mirë të racës, aftësi që përgjatë krizave të mëdha historike, është pothuaj e pagabueshme. Do të ishte në të mirën tonë t'a pohonim këtë instikt, ashtu siç do ishte e drejtë për t'ia besuar disa të paktëve kontrollin e bashkësisë.

Doktrina Fashiste e pohon me sinqeritet seriozitetin e marrëdhënieve ndërmjet kapitalit dhe punës, problem i ngritur ky nga Socializmi. Ndoshta ky problem është qendror në jetën tonë moderne. Por Fashizmi nuk bie

dakort me zgjidhjen kolektiviste të propozuar nga Socialistët. Kohët e fundit, defekti kryesor i metodës Socialiste është shfaqur qartësisht. Socializmi nuk e pohn natyrën njerëzore, pra është jashtë realitetit. Socializmi nuk e pranon që susta më e fuqishme e veprimtarive njerëzore qëndron tek interesi vetjak.

Zhdukja e këtij interesi vetjak nga fusha e ekonomisë, përfundon me paralizimin e plotë të sistemit. Shtypja e pronësisë private të kapitalit, nënkupton shtypjen e vetë kapitalit. Duke qenë se kapitali formohet nga kursimet, askush nuk do të dojë të kursejë nëse pasardhësve u mohohet e drejta e trashëgimit të fryteve të punës, por vetëm të konsumojë.

Shpërbërja e kapitalit lajmëron fundin e prodhimit, ngaqë kapitali është gjithmonë një vegël e pazëvendësueshme e prodhimit. Organizimi kolektiv i prodhimit ndiqet vetëm nga paraliza e prodhimit, meqë duke zhdukur iniciativën e interesit vetjak nga mekanizmi i prodhimit, vetë ai rrallohet dhe shtrenjtësohet. Pra siç na tregon përvoja, Socializmi na shpie në rritje të prodhimit, në shpërbërje të kapitalit, dhe në varfëri. Për çfarë na shërben pra ndërtimi i një makinerie shoqërore që shpërndan bollëk barazisht, nëse vetë bollëku shkatërrohet nga ndërtimi i po kësaj makinerie?

Socializmi bëri një gabim të pafalshëm kur u mundua të gjente padrejtësinë tek prona private, kur në të vërtetë prona private është thjesht një çështje e përdorshmërisë shoqërore. Pra njohja e pronës private, është pjesë e Doktrinës së Fashizmit, jo prej aspektit individual, por prej përdorimit në të mirë të shoqërisë.

Pra zgjidhja socialiste duhet mohuar, por problemi nuk duhet lënë pa u zgjidhur, jo vetëm ngaqë drejtësia

kërkon përgjigje, por edhe pse vazhdimi i këtij problemi në regjimet liberale dhe demokratike, ka kërcënuar rendin publik dhe autoritetin e Shtetit. Vetëmbrojtja klasore e pakufizuar, e mishëruar tek grevat, bojkotet dhe sabotazhet na çon pashmangshmërisht tek anarkia. Doktrina Fashiste duke shpërndarë drejtësi ndërmjet klasash, në përputhje me një domosdoshmëri themeltare të jetës moderne, nuk do e lejojë këtë vetëmbrojtje klasore, e cila ashtu si vetëmbrojtja individuale e kohërave barbare, është burim i rrëmujës dhe luftës civile.

Vetëm një zgjidhje është e mundur. Shteti do të realizojë drejtësinë ndërmjet klasave. Shekuj më parë, Shteti si organ specifik i drejtësisë, e shfuqizoi vetëmbrojtjen individuale në situata të diskutueshme, duke e zëvendësuar me drejtësinë e Shtetit. Ka ardhur koha për t'a zëvendësuar vetëmbrojtjen klasore me drejtësinë e Shtetit.

Për t'i ardhur në ndihmë këtyre ndryshimeve, Fashizmi ka krijuar sindikalizmin e tij. Shtypja e vetëmbrojtjes klasore nuk është shtypje e mbrojtjes klasore, e cila është një domosdoshmëri e patëhuajësueshme e jetës ekonomike moderne.

Organizimi klasor është një fakt që nuk mund të injorohet, por duhet kontrolluar, disiplinuar dhe nënshtruar nga Shteti. Në vend se të jetë një organ i mbrojtjes jashtëligjore, Sindikata duhet shndërruar në një organ të mbrojtjes ligjore, që do të shndërrohet në mbrojtje juridike, sapo konfliktet e punës të shndërrohen në çështje gjyqësore.

Fashizmi e ka shndërruar sindikatën, këtë mjet revolucionar të vjetër të socialistëve sindikalistë, në një mjet të mbrojtjes ligjore të klasave, njeherazi brenda dhe

jashtë sallës gjyqësore. Kjo zgjidhje mund të hasë në pengesa të ndryshme përgjatë zhvillimit: pengesa që vijnë nga ligësia, nga dyshimi, nga përlogaritjet e pasakta etj. Gjithsesi ky zhvillim i ri është i destinuar të ngadhënjejë, edhe pse duhet të përparojë dalëngadalë e në mënyrë të përshkallëzuar.

5. Vlera Historike e Doktrinës së Fashizmit

Mund ta çoj këtë analizë më tutje, por ajo çka thashë deri më tani është e mjaftueshme për të treguar që ngritja e një ideologjie Fashiste provon ekzistencën e një përmbysjeje në fushën intelektuale, po aq të fuqishme sa edhe ndryshimi që mbërriti në shekujt e tetëmbëdhjetë e të nëntëmbëdhjetë. Një ndryshim i sjellë nga ngritja dhe përhapja e atyre doktrinave të ligjit natyror që ndryshe quhen “Filozofia e Revolucionit Francez”. Filozofia e Revolucionit Francez formuloi parime të veçanta, autoriteti i të cilave dukej aq përfundimtar sa filluan të quheshin të pavdekshme.

Krijimi i një kulture dhe i një qytetërimi të ri u përcaktua nga ndikimi i këtyre parimeve. Po ashtu, entuziazmi i ideve të doktrinës Fashiste, do të përcaktojë kursin e një kulture dhe një konceptimi të ri të jetës civile. Ngjarja e shekullit të tetëmbëdhjetë, që çliroi individin nga Shteti, do të ndiqet nga ngjarja e shekullit të njëzet, shpetimi i Shtetit nga individi. Periudha e autoritetit, e detyrimeve shoqërore, dhe e nënshtrimit “hierarkik”, do të pasojë periudhën e individualizimit, e dobësimit të shtetit, dhe të mosnënshtrimit.

Kjo risi nuk është dhe nuk mund të jetë një kthim mbropa në kohërat e Mesjetës. Supozimi se lëvizja e prodhuar nga Reformacioni dhe e lartësuar nga Revolucioni Francez u drejtua kundër ideve dhe institucioneve mesjetare, është i gabuar. Në vend se të konsiderohet si një mohim, kjo lëvizje duhet parë si zhvillimi dhe përmbushja e doktrinës e praktikave të Mesjetës. Politikisht dhe nga ana shoqërore, Mesjeta solli shpërbërje dhe anarki; u karakterizua nga dobësimi dhe

zhdukja e përshkallëzuar e Shtetit, të mishëruar në Perandorinë Romake. Kjo Perandori u tërhoq në Lindje, pastaj në Francë, pastaj në Gjermani, si një fantazmë pa asnjë lloj vlere. Variantet e kësaj Perandorie u pllakosën nga përparimi i ngadalshëm i forcave uzurpuese, forcave shkatërruese dhe të neveritshme. Ato përndiqeshin nga gjurma e një partikularizmi ngadhënjyes.

Lëvizja individualiste dhe anti-shoqërore e shekujve të shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë nuk iu kundërvu Mesjetës, por punoi kundër restaurimit të Shtetit nga monarkitë e mëdha kombëtare. Nëse kjo lëvizje i shkatërroi institutet mesjetare që i kishin mbijetuar Mesjetës, kjo erdhi si rrjedhojë e përpjekjes kundër Shtetit.

Fryma e kësaj lëvizjeje ishte qartësisht mesjetare. Risia qëndronte tek rrethanat shoqërore në të cilat veproi, dhe në marrëdhënien e saj me zhvillimet e reja ekonomike. Individualizmi i zotërinjve feudalë, partikularizmi i qyteteve dhe i korporatave, u zëvendësuan me individualizmin e partikularizmin e borgjezisë dhe klasave popullore.

Pra ideologjia Fashiste nuk mund të shikojë mbrapa në kohë, për tek Mesjeta. Ideologjia fashiste është një mohim i plotë i Mesjetës. Mesjeta ishte shpërbërëse, Fashizmi është shoqërizues.

Jam krejtësisht i ndërgjegjshëm që vlera e Fashizmit si një lëvizje intelektuale, i huton shumë mendjet e ndjekësve dhe të mbështetësve. Ajo sigurisht mohohet që me të parën nga armiqtë. Nuk ka ndonjë ligësi në këtë mohim, sipas meje, por vetëm një paaftësi për të kuptuar. Ideologjia liberale-demokratike-socialiste, e ka dominuar për kaq shumë kohë kulturën italiane, sa që ka marrë

vlerën e një të vërtete absolute në mendjet e shumicës së njerëzve, pothuaj vlerën e një ligji natyror. Çdo aftësi për autokritikë është shtypur, kjo shtypje rezulton në një paaftësi për të kuptuar që kohërat ndryshojnë. Pra është e këshillueshme për t'u mbështetur kryesisht tek brezat e rinj, tek ata njerëz kultura e të cilëve nuk është e ngurtë.

Kjo vështirësi që haset në të kuptuarit e Fashizmit, tipar i atyre njerëzve që kanë pasur një edukim politik dhe shoqëror krejtësisht të dallueshëm, është njëri nga shkaqet pse Fashizmi nuk ka qenë tërësisht i suksesshëm me klasat intelektuale dhe me mendjet e pjekura. Është gjithashtu njëri nga shkaqet pse ka qenë shumë i suksesshëm me rininë, me gratë, me zonat rurale, dhe me burrat e veprimit, të papenguar nga një edukim i ngurtë shoqëror dhe politik.

Fashizmi si një lëvizje kulturore, vetëm sa po hedh hapat e parë. Ashtu siç ndodh me të gjitha lëvizjet e mëdha, veprimi i'a kalon mendimit. Kështu ndodhi në kohën e Reformacionit Protestant, dhe në kohën e reaksionit individualist të shekujve 17 dhe 18. Revolucioni Anglez, ndodhi kur doktrinat e ligjit natyror, sapo kishin nisur të zhvilloheshin. Zhvillimi teorik i doktrinave liberale dhe demokratike, nisi vetëm pas përfundimit të Revolucionit Francez.

Në këtë kontekst, zënia e një vendi të denjë në histori, nuk do të jetë e vështirë për këtë tendencë madhështore të mendimit që quhet Fashizëm, i cili pavarësisht vështirësive të hershme, duket se që tani i jep shenjat e rëndësisë zhvillimore.

Spekulimi liberal-demokratik, njëherazi në zanafillë dhe në mënyrën e zhvillimit, duket se është thelbësisht një formacion jo-italian. Lidhja e tij me Mesjetën, e zbulon

atë si të huaj për mendjen Latine. Fundja shpërbërja mesjetare ishte pasojë e triumfit të individualizmit Gjermanik, ndaj mentalitetit politik të Romakëve. Barbarët e mërzitshëm në shpirt dhe të egër në veprim, e shkallmuan strukturën madhështore të ngritur nga gjenialiteti Latin, duke e zëvendësuar me zbrazëti.

Anarkia zgjati për tetë shekuj, përgjatë të cilëve vetëm një institucion ishte i aftë për të mbijetuar, Kisha Katolike, një institucion Romak. Sapo procesi i lodhshëm i rindërtimit filloi me themelimin e shteteve të mëdha kombëtare, të mbështetur nga Kisha Romake, Reformacioni Protestant filloi të ngulej përmes rrymave individualiste të shekujve të shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë. Prosesi i shpërbërjes u përsërit.

Shkrimtarët që u shfaqën në shekullin 14 si pararendës të doktrinave liberale, nuk janë Italianë. Occam dhe Wycliff ishin anglezë, Oresme ishte francez. Ndërmjet idhtarëve të individualizmit në shekullin 16, që përgatitën udhën e triumfit të doktrinave të ligjit natyror mund të përmendim: Hotman dhe Languet, që ishin francezë, Buchanan që ishte scokez. Ndërmjet personaliteteve të ligjit natyror: Grotius dhe Spinoza ishin hollandezë (Spinoza ishte çifut hollandez); Locke ishte anglez, l'Abbe de St. Pierre, Montesquieu, d'Argenson, Voltaire, Rousseau, Diderot dhe enciklopedistët ishin francezë, Althusius, Pufendorf, Kant, dhe Fichte ishin gjermanë.

Kjo tendencë anti-Shtet, ishte tipar i shpirtit Gjermanik, një shpirt i cili ka dominuar popujt Gjermanikë, kudo ku Gjermanizmi ka lënë një gjurmë të thellë, edhe pse në sipërfaqe dukej sikur mbështillej nga një damar i kulturës Latine.

Italia nuk mori pjesë në ngritjen dhe zhvillimin e doktrinave të ligjit natyror. Vetëm në shekullin 19 ajo tregoi një interes të vakët në këto doktrinë, ashtu siç kontribuoi për to, me të njejtën vaktësi, nëpërmjet veprave të Beccaria dhe Filangeri.

Ndërsa në vendet e tjera si Franca, Gjermania, Anglia dhe Holanda, tradita e përgjithshme e shkencave politike dhe shoqërore punonte në emër të individualizmit anti-Shtet, pra në emër të doktrinave liberal-demokratike, Italia nga ana tjetër mbeti e mbërthyer pas trashëgimisë së të kaluarës, në emër të të cilës shpallte të drejtat e Shtetit, epërsinë e autoritetit, dhe epërsinë e synimeve.

Fakti që doktrina politike e Italianëve në Mesjetë, lidhej me shkrimtarët politikë të mëdhenj të antikitetit, Platonin dhe Aristotelin, që në një mënyrë të dallueshme por njëherazi të fortë, ishin idhtarë të një shteti të fortë dhe të nënshtrimit të individëve ndaj shtetit, është një shenjë e qartë e orientimit të filozofisë politike në Itali. Të gjithë e dimë sa i madh ishte autoriteti i Aristotelit në Mesjetë.

Për Aristotelin, forca shpirtërore e shtetit është “virtyti”, jo virtyti absolut, por ai politik, i cili përkthehet në devotshmëri shoqërore. Shteti i tij përbëhej tërësisht prej qytetarëve, qytetarë që e mbrojnë, ose qytetarë magistratë. Të gjithë të tjerët, që e furnizojnë me lëndë dhe shërbime, nuk janë qytetarë. Ata bëhen të këtillë vetëm në forma të korruptuara të demokracisë. Shoqëria pra ndahet në dy klasa, njerëzit e lirë, ose qytetarët, të cilët i përkushtohen profesioneve fisnike dhe të virtytshme duke iu nënshtruar Shtetit, si dhe skllevërit e punëtorët, që punojnë për mirëmbajtjen e Shtetit. ASkush nuk është pronar i vetes në këtë skemë. Skllevërit i përkasin njerëzve të lirë, njerëzit e lirë i përkasin Shtetit.

Pra natyrisht që Shën Thoma Akuini, shkrimtari politik më i madh i Mejsetës, thekson domosdoshmërinë e unjisisë në fushën politike, dëmin e shumësisë së sundimtarëve, rreziqet dhe pasojat dëmtuese të demagogjisë. E mira e Shtetit thotë Shën Thoma Akuni, është unjisia.

Kush mund ta mishërojë unjisinë më mirë se njëshi? Për më tepër, qeverisja duhet të ndjekë për aq sa është e mundur, udhën e natyrës, në natyrë pushteti është gjithmonë një. Në trupin fizik vetëm një organ është dominant – zemra; në shpirt vetëm një aftësi ka vlerë – arsyeja. Bletët kanë vetëm një sundimtar, kurse universi ka vetëm një sovran – Zoti. Përvoja na tregon se vendet që sundohen nga shumë njerëz, zhduken për shkak të rrëmujës, kurse ato vende që sundohen nga një i vetëm, i gëzohen paqes, bollëkut dhe drejtësisë. Shtetet që nuk sundohen nga njëshi, trazohen nga mosmarrëveshjet, duke u raskapitur vazhdimisht.

Përkundrazi, shtetet që sundohen nga një mbret, i gëzohen paqes, zhvillohen drejtësisht. Sundimi i shumicës nuk mund të sanksionohet, sepse aty ku sundon turma, të kamurit shtypen ashtu siç do shtypeshin nga një tiran.

Italia e Mesjetës, paraqet një fenomen të çuditshëm: teksa në praktikë autoriteti i shtetit shpërbëhej në një shumësi sovranitetesh konkurruese, teoria e unjisisë shtetërore dhe unjisisë autoritare, mbahej gjallë në mendjet e mendimtarëve për shkak të kujtesës së traditës Perandorake Romake. Ishte kjo kujtesë që mbështeste për shekuj fiksinin e Perandorisë Romake universale, kur në të vërtetë, ky universalitet nuk ekzistonte më.

Vepra e Dantes, “De Monarchia”, përvijonte këtë teori perandorake të ngjizur si unjisi e një Shteti të fortë

"Quod potest fieri per unum melius est per unum fieri quam plura,"¹ thotë ai në kapitullin e katërmbëdhjetë të librit. Më vonë duke e konsideruar qytetarin si një mjet për arritjen e qëllimeve të Shtetit, ai përfundon me deklaratën se individit duhet ta flijojë veten për kombin. "Si pars debet se exponere pro salute totius, cum homo siti pars quaedam civitatis ... homo pro patria debet exponere se ipsum."

Tradita Romake praktike dhe jo teorike – sepse Roma ndërtoi Shtetin më të fortë të historisë, me një burrështetësi të jashtëzakonshme, por me fare pak shkrime politike – ndikoi shumë në themeluesin e shkencave politike moderne, Nicolo Machiavelli. Machiavelli, ishte një vëzhgues i aftë i natyrës, jo një krijues i doktrinave. Ai nxorri nga studimi i historisë parime praktike të politikës. Ai e çliroi shkencën e politikës nga formalizmi i skolastikëve, duke e sjellë atë më afër realitetit konkret. Shkrimet e tij, një minierë e pashtershme vërejtjesh praktike dhe vëzhgimesh të çmuara, zbulojnë idenë e Shtetit, një ide dominante për të. Kjo ide nuk gjendej më e kredhur në abstragime, por në një konkretësi të plotë historike të unjesisë kombëtare të Italisë.

Machiavelli jo vetëm është një prej shkrimtarëve më të mëdhenj politikë, por gjithashtu është një prej bashkëkombasve tanë më madhështorë, zotërues i plotë i një ndërgjegjeje kombëtare Italiane. Për të çliruar Italinë, që në kohërat e tij ishte "e skllavëruar, e këputur, dhe e plaçkitur", si dhe për ta bërë më të fuqishme, ai do të

¹ "Çka është e bëshme nga një i vetëm, le të bëhet nga një i vetëm, e jo nga të shumtët". Shënim i redaktorit.

përdorte çdo mjet, sepse për të, shenjtëria e qëllimeve i justifikonte plotësisht. Në këtë aspekt, ai do të refuzohej mprehtësisht nga të huajt që nuk i frikësoheshin mjeteve, por qëllimeve.

Ai kërkonte ndërtimin e një Shteti Italian, të mbështetur nga sakrificat dhe nga gjaku i qytetarëve, jo të mbrojtur nga trupat mercenare. Ai kërkonte një shtet të mirërenduar për së brendshmi, agresiv, dhe të prirur për t'u zgjeruar. “Republikat e dobëta” thoshte ai “nuk zotërojnë vendosmëri, nuk mund të marrin kurrë vendime”. (Discorsi. Kapitulli i parë, faqe 38). “Shtetet e dobëta, gjithmonë kanë qenë të mbushura me dyshim përsa i përket ndjekjes së një udhe, diskutimet e ngadalta janë gjithmonë të dëmshme”. (Discorsi, Kapitulli i parë, faqja 10).

Përsëri “Kushdo që kërkon të qeverisë një shumësi, qoftë nëpërmjet një regjimi liberal apo nëpërmjet një monarkie, pa u kujdesur për armiq të e rendit të ri, përfundon me një Shtet jetëshkurtër”. (Discorsi. Kapitulli i parë. Faqja 16). Diku më tej “Autoriteti diktatorial nuk e dëmtoi Republikën Romake, përkundrazi, i erdhi në ndihmë”. (Discorsi. Kapitulli i parë. Faqja 34). Ende më tej “Republikave dhe mbretërive që nuk zotërojnë trupa kombëtare për qëllime mbrojtjeje dhe sulmi, duhet t'u vijë turp nga vetja”. (Discorsi. Kapitulli i parë. Faqja 21).

Edhe njëherë “Paratë nuk të mbrojnë, ato vetëm të ekspozojnë ndaj sulmeve plaçkitëse. Luftrat nuk fitohen nga paratë, por nga ushtarët e mirë”. (Discorsi. Kapitulli i parë. Faqja 10). “Shteti duhet mbrojtur përmes lavdisë tënde dhe çnderimit të tjetrit, secila nga këto rrugë përbëjnë mbrojtjen fisnike” (Discorsi. Kapitulli i tretë. Faqja 43). “Me këmbëngulje dhe guxim, njerëzit

pushtojnë atë që nuk do të merrej përmes mjeteve të zakonshme”. (Discorsi. Kapitulli i tretë. Faqja 44).

Makiaveli nuk ishte vetëm një autoritet politik madhështor, ai gjithashtu na mësoi si të mjeshtërojmë energjinë dhe vullnetin. Fashizmi prej tij mëson jo vetëm nga ana doktrimore, por edhe nga aspekti i veprimit.

Krejt i dallueshëm nga Machiavelli, në qëndrimin e tij, në përgatitjen kulturore dhe në mënyrën e paraqitjes, Giambattista Vico prapësëprapë duhet lidhur më Fiorentinasin e Madh. Në ditët e hershme të “ligjit natyror” Vico vendosmërisht i kundërvihet. Nëpër sulmet që i bënte idhtarëve të ligjit natyror, Grotius, Seldenus dhe Pufendorf, ai sistematikisht mbyste parimet abstrakte, racionaliste dhe utilitare të shekullit të tetëmbëdhjetë. Montemayor drejtësisht thoshte: “Teksa juristët natyrorë themelonin Shtetin dhe drejtësinë mbi utilitetin, interesin dhe sigurinë njerëzore të arsyes, me qëllimin e ndërtimit të Shtetit të përsosur dhe kodeve të përjetshme, Vico këmbëngulte për ekzistencën e një natyre shoqërore të njeriut. Vico këmbëngulte për zhvillimin e ndërgjegjes juridike përmes historisë së njerëzimit, dhe jo përmes historisë së shenjtë.

Vico mendon se doktrinat mund të fillojnë me ato subjekte që shpjegojnë rrugëtimin e mbarë qytetërimit. Përvoja, dhe jo arsyetimi, historia dhe jo arsyeja, janë mjetet që duhet t’i vijnë në ndihmë mençurisë njerëzore në të kuptuarit e regjimeve politike dhe shoqërore. Vetë këto regjime vijnë si pasojë jo e arsyes dhe filozofisë, por si pasojë e sensit komun, ose “ndërgjegjes shoqërore të njeriut”. Diku më tej Montemayor thotë “I detyrohem

Vicos për konceptimin e një historie si “magistra vitae”², i detyrohemi gjithashtu për kërkimin e njerëzillëkut të historisë, parimit që e bën të vërtetën të përparojë me kohën, i detyrohemi për zbulimin e udhës politike të kombeve.

Është pikërisht Vico ai që këndoi eulogjinë e zemrave heroike fisnike, të “baballarëve të popujve”, të themeluesve të parë të shteteve, mbrojtës madhështorë të bashkësisë, dhe këshilltarë të urtë të politikës, I detyrohemi Vicos për kritikën e demokracive, pohimin e jetëshkurtësisë së tyre, e shpërbërjes së tyre të shpejtë në duart e fraksioneve dhe demagogëve, e të tatëpjetës fillimisht anarkike, pastaj të kthesës monarkike, kur degradimi nuk i shndërron në pre të shfrytëzuesve të huaj. Vico e konsideronte lirinë qytetare si nënshtrim ndaj ligjit, si nënshtrim të drejtë të interesit vetjak ndaj atij publik.

Ishte Vico ai që ravijëzoi një shoqëri moderne si një botë kombesh ku secili ruan pushtetin e tij, kombe që luftojnë drejtësisht e jo ç’njerëzisht. Tek Vico pra gjejmë ndëshkimin e pacifizmit, supozimin që e drejta mishërohet përmes forcës, sepse pa forcë, e drejta nuk ka kurrfarë kuptimi dhe nuk i shërben askujt”.

Dallimi i analogjive ndërmjet këtyre pohimeve dhe pikëpamjeve themelore të frymës fashiste, bëhet shumë lehtë. Nuk duhet të çuditemi nga kjo ngjashmëri. Fashizmi, një fenomen qartësisht Italian, i ka rrënjët tek Rilindja, kurse Rilindja padyshim u ndikua nga Vico.

Do të ishte e pasaktë të thuhej se filozofia e Vicos dominonte Rilindjen Kombëtare Italiane. Shumë elementë të qytetërimeve gjermanë, francezë dhe anglezë,

² Udhëzuese e jetës. Shënim i redaktorit.

i janë shtuar kulturës sonë gjatë gjysmës së parë të shekullit 19. Aq shumë sa ndoshta Vico do kishte rënë në harresë, nëse një tjetër mendje e fuqishme nga Jugu i Italisë, Vincenzo Cuoco, nuk do të shpjegonte filozofinë e Vicos në ditët e ngritjes së Rilindjes Kombëtare.

Një shpjegim i plotë i doktrinave të Cuocos, do më çnte shumë larg. Montemayor, në artikullin e cituar më sipër, u jep vëmendje të konsiderueshme. Ai citon ndërmjet të tjerash, vlerësimin që Cuoco kishte për Demokracinë “Italia nuk i ka pasur punët mirë me Demokracinë. Tre bimët tona të lirisë, unjisisë dhe pavarësisë, u kalbën deri në rrënjë nga Demokracia. Nëse dëshirojmë të shikojmë lulëzimin e këtyre bimëve, duhet t’i mbrojmë ato nga Demokracia”

Ndikimi i Cuocos mbi patriotët italianë, i kryer përmes shkrimeve, artikujve dhe propagandës Vicoiane, është universalisht i njohur. Ndërmjet lexuesve të rregullt të “Gazetës Italiane”, gjejmë Montin dhe Foscolon. Copëza të artikujve të tij, konsideroheshin si të çmuar nga Mazzini dhe Manzoni, që shpesh ishin sekretarët e tij. Ata shpesh e quanin “mjeshtër të politikës”.

Ndikimi i traditës Italiane, pishtarmbajtës i së cilës ishte Vincenzo Cuoco, u ndje edhe nga Mazzini, interpretimi i të cilit mbi funksionin e qytetarit në lidhje me detyrën dhe synimin, duhet lidhur me doktrinën e Vicos, dhe jo me doktrinën filozofike dhe politike të Revolucionit Francez.

“Të stërvitesh për detyrën shoqërore” thoshte Mazzini “është logjikisht dhe thelbësisht diçka përbashkuese. Jeta është një detyrë, një mision. Norma dhe përkufizimi i këtij misioni mund të gjendet vetëm tek një pjesëmarrje kolektive më të madhe se gjithë individët.

Tek populli, tek kombi. Nëse ekziston ndonjë mision kolektiv, një bashkësi e detyrave, vetëm unjisia kombëtare mund t'a përfaqësojë më së miri". Diku më tej "Deklarata e të drejtave, e mishëruar tek të gjithë kushtetutat që duan të kopjojnë Francën, e konsiderojnë individin si qëllim, duke u marrë vetëm me gjysmën e problemit"... "Supozo ekzistencën e një krize që kërcënon jetën e kombit, dhe që kërkon flijimin e rinisë, a do t'u kërkosh njerëzve që të martirizohen një nga një? Njerëzve u ke mësuar që shoqëria ekziston vetëm për të garantuar disa të drejta, dhe tanimë, po iu kërkon të flijohen, të vuajnë dhe të vdesin për sigurinë...e kombit?"

Sipas Mazzinit, qytetari është një mjet që shërben për arritjen e synimeve të kombit, pra i nënshtuar ndaj një misioni më të lartë, ndaj detyrës së një sakrifice eprane. Ja këtu mund të qëmtohet njëra nga pikat themeltare të doktrinës Fashiste.

Fatkeqësisht, autonomia e mendimit politik në Itali, dikur energjikisht e themeluar tek veprat e Vicos, e shpjeguar fisnikërisht nga Vincenzo Cuoco, dhe e mbajtur lart edhe përgjatë luftës që zhvilloi Rilindja Kombëtare, pas arritjes së bashkimit, u zhduk. Mendimi politik Italian, që kishte arritur të mbante origjinalitetin e tij në kohërat e skllavërimit politik, u skllavërua në ditët e lirisë.

Një lëvizje e fuqishme që lindi përgjatë luftës, kërkon ta rivendosë mendimin Italian në shtratin e traditës së saj, që është edhe tradita e Romës. Kjo lëvizje është Fashizmi.

Kjo detyrë e çlirimit intelektual, nuk është më pak e rëndësishme se shpagimi politik që po arrihet përmes Revolucionit Fashist. Kjo është një detyrë e madhe, që ngërthen dhe pason Rilindjen Kombëtare. Tanimë kjo lëvizje po i jep fundin varësisë intelektuale të Italisë.

Në sajë të kësaj lëvizjeje, Italia përsëri i flet botës, kurse bota e dëgjon Italinë. Kjo është një detyrë e madhe, një vepër e madhe që kërkon përpjekje të mëdha. Në mënyrë që të përfundojë më sukses, duhet të çlirohemi nga zgjyra e ideve dhe zakoneve mendore që dy shekujt e ndikimit të huaj intelektual na dhanë. Jo vetëm duhet të krijojmë një kulturë të re, por edhe një shpirt të ri. Duhet të kontribuojmë metodikisht dhe me durim drejt një zhvillimi total dhe organik të doktrinës sonë. Lëvizja duhet mbështetur lokalisht dhe globalisht, me devotshmëri të papërkulur. Duam bashkëpunimin e gjithë Fashistëve, gjithashtu edhe bashkëpunimin e atyre që me të vërtet ndihen Italianë. Pas sakrificës, vjen koha e përpjekjeve të paepura. Për lavdinë e Italisë!